



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 31, datë 28.02.2022

MBI

SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 68, DATË 28.04.2021 “MBI PEZULLIMIN E SHPËRNDARJES SË FITIMIT TË SHOQËRIVE TË SIGURIMIT PËR VITIN 2020”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të nenit 149 e vijues të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E:

Gjatë periudhës së pandemisë, Autoriteti ka monitoruar në vazhdimësi zhvillimet në tregun e sigurimeve, duke vlerësuar rregullisht ndikimin e pandemisë Covid-19 në këtë treg.

Me vendimin nr. 68, datë 28.04.2021 “Mbi pezullimin e shpërndarjes së fitimit të shoqërive të sigurimit për vitin 2020”, është pezulluar shpërndarja nga shoqëritë e sigurimit, e fitimit të vitit 2020.

Sipas informacionit të publikuar nga Autoriteti Evropian Rregullator i Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale (EIOPA), Banka Qendrore Evropiane, apo autoritete të tjera rregullatore dhe mbikëqyrëse, në tregjet ndërkombëtare, vërehet një qasje më lehtësuese lidhur me shpërndarjen e fitimit në formën e dividendëve të shoqërive që janë subjekt i tregjeve financiare, përfshirë shoqëritë e sigurimit.

Në bazë të të dhënave më të fundit të disponuara në Autoritet (raportimet paraprake të 31.12.2021 të paaudituar), vihet re që treguesit kryesorë financiarë të shoqërive të sigurimit mbeten të qëndrueshëm dhe/ose vijnë të kenë rritje, në krahasim me vitin 2020.

Në këto kushte, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Shfuqizimin e vendimit të Bordit të Autoritetit nr. 68, datë 28.04.2021 “Mbi pezullimin e shpërndarjes së fitimit të shoqërive të sigurimit për vitin 2020”.**

2. Ngarkohet Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve dhe Drejtoria e Zbatueshmërisë dhe Parandalimit të Pastrimit të Parave, për njoftimin në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Olsi ÇOKU

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Ervin METE